



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 435/1 prot.

Tiranë, më 11 . 04 . 2023

V E N D I M

Nr. 54 , datë 11 . 04 . 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, është paraqitur ankesa nr. 51 Regj., datë 29.03.2023, e shtetasit E. P, kundër Prokurorit A. Sh, pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me pretendim diskriminimin për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë²”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ka parashtruar se:

“Me datë 16.12.2021 më është njoftuar akuza nga Oficeri i Policisë Gjyqësore (OPGJ) i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Durrës, E. D, me urdhër të prokurorit A. Sh. Lidhur me këtë akuzë mendoj se jam diskriminuar nga ky prokuror për faktin se jam anëtar i Policisë së Shtetit dhe i përkas grupit të oficerëve të Policisë. Aktualisht mbaj gradën nën/komisar dhe detyra ime është specialist i hetimit të krimeve.

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

² Duke referuar faktin që ankuesi është punonjës i Policisë së Shtetit.

Prokurori A. Sh, duke e ditur këtë fakt ka kryer një sërë shkeljesh të të drejtave të njeriut, ndër të cilat po rendis si më poshtë:

- *Jam ndaluar me datë 09.01.2020 në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, sipas një vendimi të marrë në mungesë ndaj meje dhe nuk jam marrë në pyetje nga prokurori i çështjes apo nga oficeri i Policisë Gjyqësore, për të shpjeguar faktet për të cilat jam ndaluar dhe proceduar penalisht në mungesë, në kundërshtim flagrant me nenin 256 të Kodit të Procedurës Penale.*
- *Nuk jam marrë në pyetje as gjatë hetimeve paraprake si person nën hetim, as pas njoftimit të akuzës e marrjes në cilësinë e të pandehurit, megjithëse e kam kërkuar këtë gjë kundërshtim prokurorit të çështjes, i cili në kundërshtim me nenin 327 të K. Pr.Penale nuk më ka pyetur si person ndaj të cilit po zhvillohen këto hetime.*
- *Me datë 16.12.2021 më është dhënë për t'u firmosur procesverbali i datës 02.02.2021, 14 ditë me vonesë duke kryer shkelje flagrante pasi nuk janë respektuar të drejtat e mia parashikuar në K.Pr.Penale. Njoftimi i akuzës nga prokurori i çështjes më është bërë me datë 19.11.2021, dhe në këtë akt mungon firma e avokatit.*
- *Gjatë hetimeve paraprake jam mbajtur në mënyrë tendencioze duke u diskriminuar nga prokurori A. Sh me masën e sigurisë "Arrest me burg" nga data 09.01.2020-17.03.2020, a thua se unë kisha kryer ndonjë krim të rëndë apo kisha bashkëpunuar me trafikantë droge apo pjesëtarë të krimit të organizuar, ndërkohë që jam i sigurtë se që shkeljet e pretenduara në këtë çështje si shpërdorim detyre kërkojnë një analizë objektive për t'u klasifikuar si shkelje disiplinore e jo si vepër penale.*
- *Ky prokuror ka bërë shumë padrejtësi dhe më ka diskriminuar vetëm për faktin se jam punonjës policie dhe ngaqë ka menduar se për shkak të detyrës nuk do të ankohej kundër tij. Ai vazhdon me kokëfortësinë e tij të më dëmtojë mua dhe familjen time dhe po më detyron të braktis vendin tim.*
- *Prokurori ka bërë kërkesë për të dërguar çështjen time në gjyq që prej muajit prill të vitit 2022, por akoma çështja ime nuk ka kaluar në gjykim dhe ndodhet në seancën e vlerësimit paraprak, seancat shtyhen herë pas here.*
- *I kam kërkuar prokurorit të më japë një koje të CD të përgjimeve që ka kryer ndaj meje, por nuk pranoi të mi vendosi në dispozicion, pasi dyshoj që bisedat e mia janë manipuluar me keqdashje nga ish - OPGJ, A. K , i cili është i lidhur me grupet kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike dhe person nën hetim".*

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe të shkeljeve të të drejtave të njeriut që i janë bërë nga ana e Prokurorit A. Sh.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Së pari, lidhur me kërkimin e ankuesit për evidentimin e shkeljeve ligjore të kryera nga Prokurori A. Sh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, kundrejt tij, Komisioneri vlerëson se:

- Vendimi i Prokurorit A. Sh, datë 19.11.2021, “Për njoftimin e akuzës”, është bazuar në aktet e procedimit penal me nr. 2042, datë 30.09.2019, të referuar nga Shërbimi për

Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Sektori Durrës për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248, i K.Penal.

- Nga të dhënat e këtij vendimi, ndër të tjera, evidentohet se, më datë 06.01.2020, është regjistruar emri i shtetasve: A. D, G. D, S. XH, N. M, E. P, B. D, D. D, P. N, H. Sh, N. Sh, . N, Gj. G. M. SH . J. K, për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”...”.

Bazuar në aktin e mësipërm, evidentohet se subjekti ankues ka qenë subjekt i hetimit së bashku me 13 (trembëdhjetë) persona të tjerë, të akuzuar për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”.

Lidhur me pretendimet e ankuesit se: nga ana e prokurorit të çështjes janë shkelur të drejtat e tij themelore, se ndaj tij nuk janë zbatuar parashikimet ligjore të K. Pr. Penale, se ai nuk është pyetur si person nën hetim, se vepra për të cilën akuzohet duhet të ndryshohet dhe të klasifikohet si shkelje administrative dhe jo penale, se çështja e tij ende nuk ka kaluar për gjykim e se seancat ndaj tij shtyhen qëllimisht nga ana e Prokurorit të çështjes, etj, Komisioneri vëren se, hetimi i tyre nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së.

Kodi i Procedurës Penale, në nenet 277 e 278 të tij, ka parashikuar organet kompetente që ushtrojnë ndjekjen penale dhe që shprehen e disponojnë lidhur me të, shprehimisht:

“Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale.

Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore.

Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.

Kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, sipas paragrafit 1 të këtij neni, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar”.

Komisioneri informon ankuesin se, ankimimi i vendimeve të organeve gjyqësore si dhe të prokurorisë bëhet sipas hierarkisë, në shkallët më të larta të gjykatave respektive dhe shqyrtimi i tyre është jashtë kompetencave të KMD-së.

Kodi i Procedurës Penale, në nenin 291³, të tij, lidhur me të drejtën e ankimit kundër vendimeve të prokurorit, ka përcaktuar se:

“1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e tij, brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit.

³ Vendimi për mosfillimin e procedimit.

2. *Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.*
3. *Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, i cili jep vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit. Ankimi shqyrtohet në seancë gjyqësore, por kur palët nuk paraqiten pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos mbi aktet e paraqitura.*
4. *Kur e gjen të bazuar ankimin, gjykata urdhëron prokurorin të regjistrojë procedimin dhe të kryejë hetimet e nevojshme, duke përcaktuar edhe drejtimin e tyre.*
5. *Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve. Gjykata e apelit vendos brenda 30 ditëve nga marrja e akteve”.*

Nëse ankuesi nuk do të jetë dakord me vendimin e veprimet a mosveprimet e Prokurorit, mund t'i kundërshtojë gjyqësisht dhe nëse nuk do jetë dakord as me vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë, lidhur me pretendimet e tij, atij i lind e drejta e ankimit të vendimit në Gjykatën e Apelit, bazuar në dispozitat ligjore specifike.

Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: *“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”.*

Në vendimin nr. 11, datë 27.05.2004, të Gjykatës Kushtetuese⁴, ndër të tjera, thuhet se: *“Në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, është përcaktuar se: “...vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve në kodet e procedurave ose në ligje të veçanta”. Pra, meqenëse ky pushtet ushtrohet në mënyrë të shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, asnjë organ tjetër, nuk ka të drejtë të kontrollojë e vlerësojë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të mospërfillin përmbajtjen e tyre e të ngarkojnë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Duke iu referuar praktikës së saj, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se, vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë, e se, asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë”.*

Pretendimet e ankuesit mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet kontrollit gjyqësor, ankimit përpara gjykatave të shkallëve më të larta.

⁴ *“Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, në nenin 132, të saj, ka përcaktuar se: “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim”.*

Në nenin 194/1 të ligjit nr. 115, datë 03.11.2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, përcaktohet se: *“Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”*.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e çështjeve që janë kompetencë e organeve si prokuroria e gjykata, bazuar në pretendime që lidhen me kundravajtje apo vepra penale të parashikuara në legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë, apo për më tepër kontrolli i vendimmarrjeve të Prokurorisë, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁵.

Lidhur me pretendimin se nga ana e prokurorit A. Sh janë konsumuar shkelje në detyrë, ankuesi mund ti drejtohet organeve kompetente (si, KLP) lidhur me hetimin e vlerësimin e tij.

Së dyti, lidhur me pretendimin e ankuesit se prokurori i çështjes nuk i ka vënë në dispozicion kopje të akteve të ndodhura në dosjen e tij hetimore, Komisioneri vëren se, kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e këtij kërkimi të shtetasit Ermand Petova, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁶.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Për sa më sipër, subjekti ankues mund t'i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së informimit.

⁵ Për analogji citojmë Vendimin nr. 02, datë 11.01.2021, të KMD-së.

⁶ Për analogji citojmë Vendimin nr. 194, datë 24.12.2019, Vendimin nr. 81, date 26.04.2022, të KMD-së.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 12/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues E. P, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë